



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE**

**RAPORT MONITORIMI
I ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT
TË AGJENCISË KOMBËTARE TË PYJEVE
PËR VITIN 2025**

TABELA E PËRMBAJTJES

- I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**
- II. QASJA VLERËSUESE**
- III. METODOLOGJIA E MONITORIMIT**
- IV. GJETJET E RAPORTIT**
- V. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Plani Integritetit përbën një instrument të luftës kundër korrupsionit, i cili i shërben institucionit në identifikimin, vlerësimin dhe parandalimin e tërësisë së risqeve që cenojnë integritetin. Forcimi i integritetit dhe miratimi i masave sistematike antikorrupsion janë të rëndësishme në kuadër të reformave të administratës publike, për arsye se nëpërmjet tyre synohet të garantohet një administratë publike profesionale, me etikë, integritet dhe performancë të lartë.

Plani Integritetit të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve për vitet 2024-2026, përfshin një analizë të vlerësimit të risqeve të integritetit në institucion, si dhe parashikon masa konkrete për zbatim, me qëllim përmirësimin e efikasitetit, transparencës, llogaridhënies, rritjen e besueshmërisë publike, si dhe arritjen e objektivave strategjike e specifike të institucionit. Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve është kryer kryesisht në fushën e menaxhimit financiar, transparencës, burimeve njerëzore, konsultimit publik, si dhe fusha të tjera të veprimtarisë së institucionit.

Objektivat që synohet të arrihen nëpërmjet Planit të Integritetit janë si vijon:

- Forcimi i transparencës dhe monitorimi i vazhdueshëm, duke siguruar rritjen e besueshmërisë publike;
- Burime njerëzore të kualifikuara, të qëndrueshme dhe me trajnime të përshtatshme për t'i rezistuar shkeljeve të integritetit;
- Përmirësimi i kuadrit rregullator, me qëllim forcimin e integritetit në institucion.

Në përputhje me Planin e Integritetit, si dhe me Metodologjinë e Monitorimit të Planit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore, AKP ka hartuar Raportin e monitorimit për vitin 2025, mbështetur në të dhëna të verifikueshme dhe transparente.

Monitorimi i Planit të Integritetit është një fazë e rëndësishme, për arsye se shërben për të vlerësuar nëse risqet e identifikuara janë menaxhuar në mënyrë efektive, si dhe për të konstatuar nëse janë realizuar aktivitetet dhe masat e parashikuara në planin e veprimit.

Raporti monitorimit të Planit të Integritetit për vitin 2025, jep të dhëna mbi zbatimin e objektivave dhe masave të parashikuara për periudhën e kërkuar, progresin e zhvilluar në kuadër të rritjes së transparencës, si dhe masat e ndërmarra për plotësimin dhe rishikimin e legjislacionit në fuqi, me qëllim përmirësimin dhe forcimin e integritetit.

Në Planin e Integritetit për vitin 2025, janë parashikuar për zbatim 13 masa, ku rezulton se gjatë vitit 2025 janë realizuar 11 masa dhe 2 masa janë në proces realizimi, plotësimi i dy vendeve vakante sipas procedurave për nëpunësit civilë, në pozicionin e specialistit në Sektorin Juridik dhe të Përgjegjës të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe ndryshimi i rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të AKP që nuk është realizuar për arsye objektive të riorganizimit të AKP pas ndryshimeve ligjore e konkretisht ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin” dhe miratimit me VKM të strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve dhe 4 Degëve Rajonale të saj.

II. QASJA VLERËSUESE

Raporti monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit përmban një analizë të përgjithshme të performancës institucionale për t’i rezistuar shkeljeve të integritetit, ku përcaktohet niveli i realizimit të masave të parashikuara në plan, si dhe hapat konkretë që janë ndërmarrë nga drejtoritë përgjegjëse për përmbushjen e tyre brenda afatit.

III.METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

Raporti monitorimit është hartuar në bazë të kontributit të drejtorive për të cilat ka patur të parashikuara masa për zbatim për periudhën e kërkuar. Secila drejtori ka raportuar mbi statusin e realizimit të masave, nëse janë realizuar plotësisht, vijojnë të jenë në proces dhe veprimet konkrete që janë ndërmarrë për përmbushjen e tyre.

Të dhënat e këtij raporti janë mbledhur nga personi i cakuar për hartimin e Raportit të monitorimit.

Drejtoritë/personat përgjegjës që kanë raportuar janë si më poshtë vijon:

- Drejtoria e Menaxhimit dhe Kontrollit.
- Drejtoria e Analizës dhe Performancës.
- Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

IV. GJETJET E RAPORTIT

Monitorimi i zbatimit të masave të parashikuara në Planin e Integritetit është një hap i rëndësishëm për të garantuar integritetin institucional. Konkretisht nëpërmjet hartimit të raportit të monitorimit synohet:

- Mbikëqyrja e vazhdueshme e nivelit të zbatimit të masave të parashikuara në plan;

- Forcimi i llogaridhënies publike dhe transparencës në institucion, për të siguruar rritjen e besueshmërisë publike;
- Rishikimi dhe plotësimi i vazhdueshëm i legjislacionit ligjor në fuqi, me qëllim përmirësimin dhe forcimin e integritetit.


Nga të dhënat e drejtorive raportuese të AKP, rezulton se:

Në Planin e Integritetit për vitin 2025, janë parashikuar për zbatim 13 masa, ku rezulton se gjatë vitit 2025 janë realizuar 11 masa dhe 2 masa janë në proces realizimi., plotësimi i dy vendeve vakante me DAP, ku Kodit i Etikës është përfshirë në Rregulloren e Brendshme të AKP-së., ku si Plani Integritetit dhe kjo rregullore janë hedhur në faqen Web të institucionit, www.akpyje.gov.al.

Gjithashtu në këtë faqe është dhe Koordinatori për të drejtën e informimit, ku ka një adresë www.info.akpyje.gov.al ku qytetarë, subjekte private apo OJF kërkojnë informacion, dokumenta, kërkesa që janë trajtuar konform kërkesave dhe afateve të ligjit “Për të drejtën e informimit”, ku dhe është krijuar Regjistri elektronik i trajtimit të kërkesave për informacion, si dhe ankesave.

Gjithashtu, janë trajtuar ankesa apo denoncime nga Portali i Bashkëqeverisjes, “Për Shqipërinë që Duam”, brenda afateve ligjore.

STATUSI I ZBATIMIT TË PËR VITIN 2025



Objektivi 1

Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore.

Forcimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion është shumë i rëndësishëm për një administratë publike efikase, transparente dhe të përgjegjshme në të gjitha nivelet.

Në këtë drejtim, synohet të garantohet një proces transparent për plotësimin e vendeve vakante, duke u mbështetur në parimet e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, profesionalizmit dhe paanësisë politike.

Gjithashtu, nëpërmjet këtij objektivi synohet kryerja e trajnimeve të vazhdueshme me qëllim forcimin e integritetit të punonjësve, njohja me rregullat e etikës si dhe përmirësimi i njohurive të punonjësve, sipas fushës së veprimtarisë së institucionit. Me qëllim përmbushjen e këtij objektivi gjatë periudhës raportuese, janë realizuar masat si vijon:

Lidhur me kryerjen e trajnimeve, specialistët e AKP kanë kryer gjatë vitit 2025 trajnime të organizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike dhe aktorë të tjerë.

Objektivi 2

Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe mekanizmave të kontrollit.

Mekanizmat dhe instrumentat aktuale të kontrollit administrativ kanë garantuar zbatimin e kuadrit të brendshëm rregullator.

Objektivi 3

Garantimi i transparencës më të lartë të punës dhe veprimtarisë së brendshme të AKP-së me Publikun.

“Forcimi i transparencës dhe monitorimi i vazhdueshëm, duke siguruar nivelin më të lartë të transparencës për publikun” përbën një ndër objektivat kryesor që synohet të përmbushet. Ky objektiv paraqet një rëndësi thelbësore, për arsye se nëpërmjet një procesi transparent, garantohet llogaridhënia dhe rritet besueshmëria publike mbi veprimtarinë e institucionit.

Me qëllim përmbushjen e këtij objektivi gjatë periudhës raportuese, janë realizuar masat si vijon:

Në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lidhur me auditimet e kryera në 6 bashki, Grupi Punës së AKP ka kryer kontrole në bashkitë Skrapar, Dimal, Krujë, Kurbin dhe Poliçan, duke lënë akt konstatimet dhe rekomandimet përfundimtare për zbatim, si dhe ka dërguar informacion Ministrisë së Mjedisit dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Përditësimi i informacionit në faqen web të AKP;

Pasqyrimi i aktiviteteve të zhvilluara nga AKP, si dhe projekte të ndryshme.

“PËRMIRËSIMI I KUADRIT RREGULLATOR, ME QËLLIM FORCIMIN E INTEGRITETIT NË INSTITUCION”

Ky objektiv thekson rëndësinë e rishikimit dhe përmirësimit në mënyrë të vazhdueshme të kuadrit rregullator, me qëllim forcimin e integritetit në institucion. Përmirësimi dhe rishikimi i vazhdueshëm i kuadrit rregullator ndikon në rritjen e efikasitetit, transparencës, llogaridhënies e besueshmërisë publike, si dhe arritjen e objektivave strategjike e specifike të institucionit.

Nuk ka patur asnjë rast të thyerjes së etikës apo disiplinës në punë.

Nuk ka patur asnjë rast konflikti interesi në procedurat e ndjekura administrative, ku si ligji vendas dhe procedurat prokuruese sipas Komisionit European për një Projekt sipas PRAG, Projekti i Procesionares, kërkojnë plotësimin e deklaratës së konfliktit të interesit nga anëtarët e Komisionit.

Nuk ka patur asnjë rast moskthimi përgjigje edhe kur çështja e shtruar për zgjidhje nuk ishte në kompetencën ligjore të AKP, duke ja drejtuar kërkesën pa vonesë institucionit kompetent, si dhe duke vënë në dijeni kërkuarësin.

Aktivitetet kryesore të AKP janë pasqyruar në faqen Web të saj dhe përditësohen, dhe shumë aktivitete ndërgjegjësuere e promovuese lidhur me pyjet janë hedhur në rrjete sociale si Facebook dhe Instagram.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Raporti i monitorimit, si një proces vetmonitorimi është kryer në përputhje me Metodologjinë e Monitorimit të Planit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore, miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr. 553, datë 30.09.2021, “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore”.

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën vitin 2025, rezulton se:

- AKP ka vijuar me përmbushjen e masave të parashikuara në Planin e Integritetit.
- Janë realizuar trajnime të vazhdueshme me qëllim forcimin e integritetit të punonjësve, si dhe përmirësimin e njohurive të tyre, ku 18 nëpunës janë trajnuar për tema të ndryshme.
- Plotësimi i vendeve vakante të AKP, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike sipas një procesi transparent dhe të drejtë, mbështetur në parimet e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, profesionalizmit dhe paanësisë politike.
- AKP po vijon me angazhimin maksimal për realizimin e masave të tjera të parashikuara në plan, brenda afateve të caktuara.